

E DIEL  
10 shtator  
2017

MILOSA

email: miosaozuus@yahoo.com



DR. ARIAN LEKA

**M**egjithëse sugjero het mirëkuptim në përdorimin e ngushtë të termave "letërsi të vogla" / "letërsi e margjinave" / "gjuhë të mëdha" / "gjuhë minore" apo "kulturë / gjuhë e shkrimtar periferish"<sup>1</sup>, sa herë që përkufizojmë nocionin letërsi e gjuhëve të vogla jemi thuajse në një mendjeje se në kuadrin e "kulturës globale" krijimtaria letrare e këtyre gjuhëve e humbet autonominë, duke u bërë e varur nga përkthimet, përkthyesit dhe nga shtëpitë botuese. Pjesë e kësaj vartësie është edhe letërsia shqiptare.

Përmes këtyre termave studiuesi Theo D'haen rikthen në kritikën letrare konceptin e një "perspektive botërore" në të vështruarit e letërsisë. Përveç këtyre, kërkohet marrëveshje edhe në përdorimin e përkufizimeve "kulturë / gjuhë e shkrimtar periferish" apo "kultura të vogla"<sup>2</sup> dhe "letërsi e margjinave"<sup>3</sup>

Në punimin e saj *Not Small Minor*<sup>4</sup> studiuesja Jana Bukova mbështet mendimin se të përkthyerit e librave prej "letërsive të vogla" drejt gjuhëve kryesore është një akt që shkon kundër ligjit të gravitetit. Por duke e vështruar përkthimin e këtyre letërsive si domosdoshmëri, ajo propozon dy mekanizme për zgjimin e interesit të zonave të mëdha kulturore e gjuhë-

sore ndaj letërsive më të vogla. Thënë me fjalët e studiueses, kjo parasheh futjen në fokusin e shikimit të *small literatures* drejt *major languages*.

Ngaqë vijmë nga sponde historike, sociale dhe kulturore të ngjashme, konstatimet e mëposhtme mund t'i shërbejnë letërsisë shqipe dhe autorëve shqiptarë për të filluar daljen nga izolimi letrar përmes projekteve

dhe iniciativave të përbashkëta mes institucioneve publike të kulturës, autorëve, përkthyesve letrarë.

Mekanizmi i parë që nënvijëzohet është vëmendja institucionale, shoqëruar me nisma dhe veprime "protranslatore". Pas këtyre hapave, angazhimi i sferës publike dhe private të kulturës së shkruar, përfshirja e kritikës letrare, shprehja e botës aka-

demike, sistemi i vlerësimit, i nxitjes së leximeve publike, qarkullimi i energjisë së krijuar në medie dhe në jetën universitare, si pjesë e lëvizjeve brenda sistemit, janë reagimi i pritshëm.

Edhe pse deri më sot, me përjashtimet e disa nismave të viteve të fundit, nuk ka funksionuar kështu, utopia bëhet e nevojshme, sidomos për vende si Shqipëria, ku me letërsi përfyty-

rohet vetëm shkrimi dhe botimi i krijimtarisë letrare, por jo edhe mbartja e saj përtej kufijve kulturorë e gjuhësorë. Elementet e tjerë, që i zgjerojnë vlerën e përdorimit këtij produkti kulturor, si promovimi, nxitja e kulturës së leximit dhe shkrimtaria e përkthimi letrar si profesione të lira (*freelance*), mbështeten pak, qoftë edhe në krahasim me rajonin.

→ Vijnë në faqen 14

## Autori shqiptar është jetim!

Në këtë numër: Andreas Gottsmann, Arian Leka, Gjergj Frashëri, Miroslav Çurçiq etj. ...

A

ARGUMENT

Me gjithë vëmendjen e shtuar dhe nismat më të fundme të Ministrisë së Kulturës, tek të cilat janë vërejtur fryte, por që shpresohet dhe pritet rezultat më shumë se thjesht prani apo pjesëmarrje (si në rastet e Panairëve Ndërkombëtarë të Librit) kur vjen fjala për projekte afatgjata dhe të bashkërenduara me faktorë të tjerë dhe sidomos kur nënvizohen qëllime, duhet thënë se edhe pas autorit shqiptar nuk qëndron ende askush.

# Braktisja e Periferisë Letrare

NGA DR. ARIAN LEKA

Këtyre projekteve u drejtohen konstatimet dhe pyetjet e Bukova-s, kur shtrou pyetjen të kush qëndron prapa autorëve të letërsive të vogla. "Prapa autorëve hungarezë qëndron shteti hungarez. Prapa autorëve kroatë, siç e dimë, qëndron shteti kroat. Pas suksesit të një të autori aq të vështirë dhe çoroditës si Çartărescu, qëndron dhe shihet shteti rumun". Po pas autorëve të letërsive të tjera, që shkruhen në gjuhë të vogla kush qëndron? "Askush!"

Pas tyre nuk shihet askush si përfaqësimit institucional. Gjithçka vëzhgohet si një nismë personale, pa qëllim të mëtejshëm.

Me gjithë vëmendjen e shtuar dhe nismat më të fundme të Ministrisë së Kulturës, tek të cilat janë vërejtur fryte, por që shpresohet dhe pritet rezultat më shumë se thjesht prani apo pjesëmarrje (si në rastet e Panairëve Ndërkombëtarë të Librit) kur vjen fjala për projekte afatgjata dhe të bashkërenduara me faktorë të tjerë dhe sidomos kur nënvizohen qëllime, duhet thënë se edhe pas autorit shqiptar nuk qëndron ende askush.

Iniciativat që ekzistojnë, përfshi këtu edhe ato me mbështetjen e Komisionit Europian, e kanë pasuruar mjedisin letrar, kanë zgjeruar mundësitë, por nuk kanë mundur ende të krijojnë një sistem. Faza e parë e këtyre iniciativave do të ishte identifikimi dhe informimi e audiencave të huaja që interesohen rreth emrave dhe panoramës së letërsisë shqiptare, rreth letërsisë bashkëkohore kryesisht, por edhe të brezave të ndryshëm letrarë e të kulturës së shkruar shqiptare në përgjithësi.

Ky propozim, me gjithë mangësitë, ekziston formalisht në faqen e Ministrisë së Kulturës, ndonëse nuk ka të dhëna mbi dobinë. Aty nuk dallohet përfshirja e informacionit apo të dhëna sistematike mbi listën të gjithë librave të autorëve shqiptarë të përkthyer në gjuhë të huaja, mbi përkthyesit dhe mbi shtëpitë botuese të tyre jashtë Shqipërisë, gjë që mund të bëhej ftesë tërheqëse për botuesit e huaj. Ky fakt, veç mosinformimit, nxit edhe mitet letrare të periferisë. Gjithashu, edhe faqet web apo rrjetet sociale të shtëpive të njohura botuese nuk kanë ende një buton a një rubrikë në gjuhë të huaja mbi propozimet që ato bëjnë në dobi të autorëve shqiptarë që ata vetë botojnë. Aty nuk gjen as tituj, as synopsa të librave dhe as ndonjë promovim që mund t'i vinte në lëvizje botuesit e huaj drejt autorëve shqiptarë. Kjo bën që konfigurimi i sistemit t'ndodhë për matuar vetëm drejt modelit marrës, një importues i thjeshtë pa produkt, pa propozim.



Arian Leka

Elemente që do të dëshmonin praninë e një sistemi do të ishin bashkërendimi i projekteve dhe marrëdhënia me produktit kulturor. Por kjo marrëdhënie nuk vërehet mes veprimtarisë së institucioneve shtetërore, që emetojnë politika kulturore dhe fonde nxitëse dhe faktorëve të tjerë aktivë, si për shebull shoqatat e autorëve e të përkthyesve letrarë, joekzistente apo jofunksionale.

Bashkëpunimin nuk vërehet as mes revistave letrare dhe mes atyre që ndajnë çmime për letërsinë, as mes shtëpive botuese vendase dhe shtëpive botuese prestigjioze në Europë e më gjerë, nuk dallohet bashkërendim as mes portaleve, që kanë në vëmendje tekstin letrar dhe as mes festivaleve, që pasurojnë skenën dhe klimën kulturore, nuk ka përkim projektësh as mes shoqatave të botuesve me libraritë që kanë kënde leximi, mes agjentëve letrarë dhe shpërndarjes e shitjeve online të librit elektronik mes atyre që organizojnë promovime të thjeshta dhe atyre që organizojnë panairë kombëtarë apo lokalë. Çdo gjë, për të mos e tepruar me fjalën



## Monopoli i emrave

Por vetë prania e dy tipareve: ai i "monopolit të emrave" (janë thuar po ata emra që përkthehen) dhe tipari i "hapësirës së gjuhëve" në të cilat është përkthyer letërsia shqipe (që, me ndryshime fare të pakta mbetet pa zgjerim po ajo) dëshmon se letërsia në gjuhën shqipe vazhdon të përhapet ngadalë. Edhe prirja për zgjerim të hapësirës drejt qekishtes, polonishtes apo gjuhëve që u shfaqën pas shtyrjes së ish-Jugosllavisë, shoqërohet me skepticism, si çdo rast i veçantë.

rënie, është rrjedhë e lirë, jashtë pretendimeve për të patur një sistem funksional.

Veç nismave institucionale dhe ekzistencës së një sistemi të brendshëm, si mekanizëm i dytë për daljen e një letërsie të vogël nga izolimi, shihet gjithashtu edhe prania e një "autor-qendër" brenda këtyre letërsive.

Kur ky "autor-qendër" dhe i suksesshëm ekziston, ai shndërrohet në faktor për rritjen e vëmendjes dhe pritshmërië dhe ndaj emrave të tjerë brenda "letërsisë së vogël". Si ilustrim të rastit "autor-qendër" brenda letërsive të vogla jana Bukova ofron rastin shqiptar, duke dalë në këtë përfundim: "...që nga momenti kur emri i Kadarese bën të ditur në hartën letrare praninë e vendit, shanset janë të hapura automatikisht edhe për autorët e tjerë shqiptarë...".

As ky mekanizëm duket se nuk ka funksionuar në rregull, së paku jo siç ka qenë pritshmëria e autoreve apo siç do të kishim dashur. Për të mos iu rikthyer mungesës së një sistemi funksional të brendshëm, shtojmë se mundësitë e humbura tregojnë se, më fort nga institucionet, janë shkrimitarët ata që e kanë kuptuar se transferimi letrar në gjuhë e kultura të tjera nuk është thjesht çështje emrash të përveçëm dhe vullnetesh vetiakë.

Por vetë prania e dy tipareve: ai i "monopolit të emrave" (janë thuar po ata emra që përkthehen) dhe tipari i "hapësirës së gjuhëve" në të cilat është përkthyer letërsia shqipe (që, me ndryshime fare të pakta mbetet pa zgjerim po ajo) dëshmon se letërsia në gjuhën shqipe vazhdon të përhapet ngadalë. Edhe prirja për zgjerim të hapësirës drejt qekishtes, polonishtes apo gjuhëve që u shfaqën pas shtyrjes së ish-Jugosllavisë, shoqërohet me skepticism, si çdo rast i veçantë.

Shenja inkurajuese të thyerjes së "monopolit të emrave" dhe zgjerimit të "hierarkisë së gjuhëve" kanë mbërritur nga rrjeti europian Traduki, një network ky që ka mbështetur përkthimin dhe botimin letërsinë shqipe në gjermanisht dhe në gjuhët e Europës Juglindore.

Si shtyrje e monopolit vërehet edhe fakti se ndër 11 autorë të gjuhës shqipe të përkthyer në pesë vite nga ky rrjet, 7 i përkasin letërsisë së re në gjuhën shqipe (Lindita Arapi, Luljeta Lleshanaku, Beqë Cufaj, Mimoza Ahmeti, Arian Leka, Veton Surroi etj). Pasurim vërehet edhe në emrat e rinj që i shtohen listës ekzistuese e të mirënjohur të përkthyesve nga shqipja drejt gjermanishtes apo gjuhëve të rajonit (Loreta Schillock, Andrea Grill, Ilir Ferri, Lindita Arapi).

Nga sa u përmend, mund të krijohet përshtypja se kemi të bëjmë me fillimin e një ere të re të letërsive shqipe drejt gjuhët e tjera, por nuk është krejt kështu. Por, me gjithë përpjekjet, kjo letërsi vijon të mbetet e izoluar brenda "toposit kulturor" shqiptar. Mes letërsive të rajonit, ajo është më pak e përkthyer në gjuhët e mëdha dhe më pak e përfaqësuar në zërat enciklopedikë të apo në kurrikulat universitare të kontinentit, ku studiohen letërsitë e rajonit. Kjo letërsi është pak e pran-



ishme madje edhe në libraritë e Kosovës dhe të Maqedonisë, ku ndërmyetësimi i përkthyesve nuk lipset.

Në vend të transferimit të një kulture shkimore, sot përjetojmë një transferim a një trafik emrash të pakët të cilët, natyrshëm mëtojnë braktisjen e periferisë letrare. Po cili do të ishte sistemi dhe standardi i këshilluar? Cilat do të bëheshin institucionet e referencës dhe cili do të duhej të ishte roli i tyre drejt perspektivës më të mirë të letërsive shqipe?

Vërejtjet të artikuluar më herët mbi mungesën e përkthyesve, të një shtëpie përkthyesi, të interesimit nga ana e botuesve dhe lexuesit të huaj etj e kanë qëmtuar imët procesin dhe brenda. Këtyre i shtohet edhe mungesa e Agjencisë së Librit, si një koordinator që do të kishte si detyrë parësore promovimin dhe mbështetjen e librit dhe të autorëve shqiptarë në gjuhë të huaja, që ndërmyetësimi i një rregullator, që ndjek letërsinë nga krijimtaria drejt promovimit pas botimit dhe që bëhet hallkë që shkrimitarët e këtyre "letërsive të vogla" të mos e përjetojnë si fatalitet, fatin e që qenit autor i një gjuhë jo shumë të përhapur, siç është gjuha shqipe.

Në të vërtetë, që prej pesë vitesh Shtëpia e Shkrimitarit dhe e Përkthyesit letrar "Tirana in Between" ekziston, duke përmbyshur një kusht, gjithsesi jo të mjaftueshëm. Ekzistojnë edhe përvoja të tilla si "rasti Haemus", në Rumanqi, që përkthen dhe boton letërsinë e traditës dhe atë bashkëkohore shqiptare në rumanisht. Madje edhe përkthyes nga shqipja në gjuhë të huaja ekzistojnë, por ata janë të papërfshirë në projekte të besueshme dhe afatgjata, ata nuk janë ende pjesë e pasurisë dhe e produktit kulturor kombëtar.

Vërejtjeve se çfarë na mungon, mund t'u shtojmë edhe se ku mungojmë ose ku shfaqemi si të padukshëm. Veç panairëve ndërkombëtarë të librit, konferencave, projekteve e trajnime, ku ne mungojmë, në ditë të mëdha është edhe një seminar ndërkombëtar mbi përkthimin, që zhvillohet përvitshëm në Slloveni, e ku në mbi pesë vjet, mes 80 të pranishmëve nuk ka pasur asnjë përkthyes nga Shqipëria.

Por ndërsa përmendim mangësitë dhe përpjekjet e pamjaftueshme, ndalemë edhe mbi faktorin e artikuluar edhe më herët: "mungesë e cilësisë letrare në letërsinë shqiptare".

Lidhur me cilësinë letrare qortimet e përcjella si nga brenda sistemi ashtu edhe nga jashtë tij, nga kritika, botuesit, përkthyesit apo lexuesit e huaj. Nga njëra anë ndeshim heshjen e kritikës së brendshme apo shprehjen e tij përmes "subjektivizimit spontan", në rastin më të mirë apo dëmtimin e

# KOLEKSION

NGA BEN ANDONI

Klodian Luca nuk zgjodhi bujën që shoqëron shumë aktivitetet boshe arti, e që rëndom mbushin faqet e gazetave dhe kronikat. Madje, bëri dhe një gabim taktik, kur ekspozitën e tij e zhvendosi në muajin më të nxehtë të vitit. Por me sa duket, ai nuk synoi bujën por shpalosjen e një ekspozite të tillë, që sollë risi por edhe tejet qasje për publikun e gjerë. Ekspozita fine “Trakt” në galerinë Ironbush të Pazarit i Ri do mbahet mënd gjatë për të gjitha rëndom dhe mesazhet e shpalosura. E para, për të sjellë për publikun një periudhë, që sot i shmangen të gjitha instancat, ndërsa e dyta një përcjellje të artit klandestin të kohës së Luftës së Dytë Botërore. Kuptohet sepse kushtet, mundësitë dhe fshhtësia nuk mund t’i atribuojë ndonjë art të madh produkteve subversive të kësaj kohe, porse ideja, mesazhet kanë qenë të mëdha. Flitet për traktet, mjete propagande volante, që shpërndaheshin në mënyrë të fshhtë nga komunistët për të njohur popullin me luftën. Por, nuk ishin vetëm këto, në ekspozitë pati edhe trakte që flisnin për Shqipërinë Etnike. Kishte shumë syresh ku flitet sesi gjermanët bëjnë thirrje për Shqipërinë Etnike, ashtu si kishte trakte italiane, që për shkak të përvojës ishin më të mira grafiksht. Ato drejtohen për pavarësinë e Shqipërisë. Kemi sërish italianët që hedhin trakte në Shqipëri të ndalojnë Rusinë, sepse do të dalë në Adria-



Për ideatorin Klod Luca qëllimi i ekspozitës ka qenë një lloj paralelizmi i shpërndarjes së mesazhit masiv në kohën e Luftës së Dytë Botërore krahasuar me atë të sotëm. Ai vetë e quan “Facebook” të atyre viteve, mesazhin prej shpërndarjes së trakteve duke aluduar se kjo formë ishte e njëjta për të ndihur një shoqëri për të shpërthyer, për të ngritur një lloj revolucioni të heshtur, për të ndarë një opinion, i cili i kalonte kufijtë e një gazete ose të censurës. Apeli, që ai shpalosi, pak ditë më parë kishte të bënte me njohjen e publikut, sidomos atij të ri me këtë episod të kohës...

## Traktet e luftës dhe nderimi ndaj një të apasionuari të artit

tik, të gjitha këto të shoqëruara me karikatura ose skica të forta dhe me cilësi. Traktet e Partisë Komuniste Shqiptare shoqërohen gjithmonë me thirrjet: Partia Komuniste Shqiptare, e me sloganin patetik Vdekje Fashizmit- Liri e Popullit. Në ekspozitë u shpalosën edhe mesazhe të Enver Hoxhës. Ashtu si merret me mënd, në vitezë e para traktet shkruheshin e vizatoheshin me dorë. Edhe pse nuk paraqesin ndonjë nivel të lartë artistik, sipas Klodian Lucës, që shpaloset jo vetëm si organizues i këtij aktiviteti por edhe si një njohës i mirë i artit figurativ, ato përcjellin në thelb një lloj ideali që edhe sot përcjell shumë mesazh për artin grafik të kësaj periudhe historike. Të 120 traktet e paraqitura në këtë aktivitet kanë përmbajtur vizatime grafike të ndryshme, që cilësisht nuk mund të konsiderohen si shumë të arrira, porse janë të gjitha me shumë vlerë për mesazhet. Kujtojmë se populli i thjeshtë, të kujtojmë përqindjen e lartë të analfabetizimit, e kish të mjaftueshme për të marrë mesazhet, por edhe gjëra që ndodhin në arenën ndërkombëtare.



Për ideatorin Klod Luca qëllimi i ekspozitës ka qenë një lloj paralelizmi i shpërndarjes së mesazhit masiv në kohën e Luftës së Dytë Botërore. Ai vetë e quan Facebook të atyre viteve, duke aluduar se kjo formë ishte e njëjta për të ndihur një shoqëri për të shpërthyer, për të ngritur një lloj revolucioni të heshtur, për të ndarë një opinion, i cili i kalonte kufijtë e një gazete ose të censurës së asaj kohe, e cila ka qenë shumë aktive. Apeli, që ai shpalosi, kishte të bënte me njohjen e publikut, sidomos atij të ri, për t’u njohur me këtë episod të kohës. Ideja e tij është tejet ngacmuese, kur shton edhe faktin e mungesës së komunikimit dhe burimit



shumë të kufizuara, kur atëherë radio do konsiderohej si një luks i paparë dhe mbi të gjitha privilegj i fare pak njerëzve. Nëse një njeri i ka parasysh të gjitha këto elemente, atëherë e kupton këtë punë të madhe që ka bërë Luca, një njohës i mirë i artit figurativ, koleksionist shumë interesant dhe mbi

të gjitha me ide interesante. “Unë po kërkoja diçka që ka të bëjë me folklorin shqiptar. Kisha dëgjuar për diçka që ka të bëjë për materiale të filmave të vjetër shqiptarë. Doja që të bëja diçka me posterat e filmave shqiptarë, por këtë moment ishte shumë e vështirë. Duke kërkuar për këto posterat dhe duke mblend një koleksion me dokumente të koleksionistët pashe traktet dhe lindi ideja për ekspozitën”, do të thotë për median, në ato ditë. Ekspozita ka qenë tejet interesante sepse këto trakte mbajnë në vullat e tyre jo vetëm vitet e një Shqipërie në luftë me të tjerët, por edhe në përballje me veten e vet, si për shembull trakte si kjo këtu ku gjermanët u kërkojnë tregtarëve të Korçës të mos rrisin çmimet, për vetë popullin e tyre. Pasojë e kësaj ndërmarrje të jashtëzakonshme ishte se kjo vilë, në ditët e ekspozitës, tek Pazarit i Ri, ku u përballën dokumente origjinale do sillte impakt të publiku. Një element tjetër ka qenë komenti i kuratorit Luca për to, që zbuloi nga autorët e deri te gabimet drejtshkrimore, pasi një pjesë e tyre ishin produkte edhe të të huajve. Ajo që mbeti nga ky aktivitet ishte se patëm një ekspozitë të mrekullueshme me një koleksion të qasshëm për publikun, por mbi të gjitha kuratori na shpalosi me një element edhe një nderim për atë kohë.

cilësisë letrare dhe çorientimin e lexuesit, përmes çmimeve-vlerësimeve letrare të përvitshme. Kjo ka sjellë mungesë të rregullit informacioni dhe keqinformim tek megasistemi i interesuar ndaj letërsisë së përkthyer që shkruhet në gjuhën shqipe, por edhe ngurrim të institucioneve vendase për ta mbështetur më fort këtë letërsi. Pa përmbushjen këtyre parakushteve, pra shprehjen e sistemit periferik përmes referencave dhe konfirmimit ndaj cilësisë letrare, nuk kemi arsye të besojmë se fati i përkthimit nga shqipja drejt gjuhëve të huaja do i interesojë sistemit qendror. Ky produkt letrar nuk do të ketë fat të ndryshëm nga ai i produktit kulturor mbi të cilin nuk investohet ose investohet keq nga qëllime të shprehura qartë. Nga ana tjetër edhe sistemi qendror ka shprehur rezervë ndaj cilësisë letrare. Kjo sidomos lidhur me pranimin e klisheve tematike dhe stilistikore, me humbjeljen e bashkëkohësive dhe të originalitetit, mbi rikthimin në stereotip kulturor si dhe mbi një lloj pezullimi letrare që luhet mes real-tradicionizmit të fundviteve ‘90 dhe në postmodernizmi të vonuar në mjete shprehëse, mes tekstit simbolist e hermetik dhe moralizmit ndaj lexuesve, pëllqimi i të cilëve gjithashtu luhet

mes asaj që i ofron narrativa ndërkombëtare dhe teksteve “cool” dhe “strange” dhe “light” të teksteve të autorëve shqiptarë, ku ajo që rrëfëhet, ngjarja pra, sundon mbi stilin letrar, a thua se letërsia nuk është më art në përdorimin e fjalës, por thjesht një fak . Më së pakti janë dy nga vërejtjet e dukshme, që mbërrijnë më shpesh në adresë të letërsisë së sotme shqipe, sidomos nga jashtë sistemit letrar kombëtar: përshatja apo imitimi stilistikor, si dukuri kaqher-shme në fenomenin e vonesës në letrat shqiptare dhe klisheja e zhanrit apo e tematikës, si stereotip i detyruar prej modeleve sunduese. Çështja e klisheve së zhanrit dhe tematikës, lidhet me trysinë që kulturat dhe gjuhët sunduese, ushtrajnë ndaj modeleve më të vogla letrare. Është i njohur fakti se po aq sa letërsi, superfuqitë kulturore eksportojnë modele, të cilat letërsitë më të vogla i përjetojnë si grishje për ndërkombëtarizim të prirjes letrare. Kësajsoj, edhe ajo pak “autonomi estetike” e pretenduar edhe për letërsitë të vogla, cenohet, duke krijuar supozimin e një letërsie që shkruhet duke pasur parasysh jo lexuesin vendas, por tregun e huaj të leximit. Ky lloj migrimi apo trafikuri ndërkombëtar nga periferia drejt

qendrave kulturore ka krijuar te autorët e letërsive të vogla, përfshi këtu edhe shkrihtarët shqiptarë, iluzionin se temat e suksesshme të një periferie mund të sigurojë sukses edhe për periferitë e tjera. Është krijuar tashmë iluzioni se temat e përqeshjes së vonuar ndaj regjimit, zhanri auto-fiction, “true-story”, teksti i angazhuar politik etj, të sjell lehtësi në gjetjen e tregut ndërkombëtar. Vendin e zonave gjeopolitike duket se e kanë zënë zonat gjeoprozodike, saje të cilave prej letërsisë së rajonit tonë tregu global ka mirëpritur me duartrokjetë, duke i siguruar popullaritet në lexim, temave të tragjizmit ballkanas, letërsinë e krimtit, të konfliktit ndëretnik, të traumave sociale dhe luftërave civile, të njeriut nën komunikim siç edhe veshjen me “multikulturizëm”, “bashkëjetesë dhe tolerancë”.

Letërsia shqipe e ka dekurruar tanimë ekzotikën e diktaturës më të egër, absurdin e vitit ‘97, krizat humanitare, emigrimet masive, ateizmin, konfliktin ndëretnik, enigmën dhe simbolikën e bunkerëve, piramidës, të kanunit dhe të burrneshave. Ç’mund të propozojë ajo pas kësaj? A do të shndërrohet edhe letërsia shqipe në një industri-fason, që punon me material të posuritur, gjysmë të gatshëm dhe që konsumat

torin që i sjell popullaritet e ka jashtë kufijve gjuhësore dhe kulturorë? A do e ruajë ajo autonomi tematike dhe kur të jenë demistifikuar temat e hapjes së dosjeve, të shpëtimt të hebrenjeve apo të mafias me trafikantë lokale? Nga ndjekja e letërsisë shqipe në vite mund të vërehet se një pjesë e krijimtarisë letrare në shqip ka filluar të shkëputet nga klisheja e mikrotoposit. Ndërkaq mund të jemi më të gatshëm për të mirëpritur të mbështetur nisim që, veç studentëve shqiptarë që sprovohen drejt mësimt të gjuhëve të huaja, ku besohet se mentorët i nxisin drejt përkthimtarisë letrare, të përfshijmë në këto hulli edhe studentët apo lektorët të katedrave albanologjike të universiteteve europiane, me shpresë qëmtimin mes tyre të elementeve që të shkollë të re e më të plotë në përkthimet letrare, që jo vetëm e vijon traditën, por edhe e parashikon atë traditë, duke ndihur që një “letërsi e vogël”, por jo e parëndësishme, të dalë nga izolimi kulturor dhe t’i kapërcëjë muret ar-ficiale të komunikimit.

<sup>1</sup> Ben Andoni, "Koleksion", GAZETA SHQIPTARE, 10 Shtator 2017.  
<sup>2</sup> Referuar: Gyrdry M. Valda, Einleitung, Marginalie Literatur, "Komparatistische Hefte", VII, 1983, pp. 5-14. Autorit referohet krijimtarisë së F. Kafka-s, nga pozicioni i hebrenjeve në Praga dhe zotëdhësis së këllit autori për të shkruar në gjermanisht e jo në çekisht apo jidish, duke sjellë me këtë rast konceptualizimin e termit letërsi "marginale" brenda kuadrantit kulturor dhe të letërsisë botërore.  
<sup>3</sup> Bukova, Jana, Not Small, Minor, Studi Slavistici (2014), 1:227-236, Firenze University Press - issn 1824-7811 (online)  
<sup>4</sup> Fu aliv, Faza 228.  
<sup>5</sup> Referuar: Jana Bukova, Not Small, Minor, pp. 228.  
<sup>6</sup> "A universally familiar example is the one of Albanian literature: since the moment that Kadare's name announces the country's presence in the literary map, the chances are automatically opened up for other Albanian authors."

D

DOKUMENT

## Afera Vujiçiq

(Vijon nga numri i shkuar)

Strossmayer me 26 nëntor 1896 jep dorëheqje nga posti i Administratorit Apostolik për Serbi. Propaganda Fidee kishte dërguar në Serbi patri minor nga Bosnia Ivan Vujiçiq, i cili si Vikarit Apostolik këtu ai do duhej të përfaqësonte interesat e Kishës Katolike. Përveç atij në vend kishte edhe mëtutje dy misionarë tjerë: Lujo Topolkoviç në Beograd dhe R. Biljan në Kragujevc, i cili pas largimit të detyrueshëm të Czock-it kujdesej edhe për katolikët e Nishit<sup>1</sup>. Në Serbi kishte një kërkim lidhur me dorëheqjen e të padëshruarit Strossmayer mirëpo jo edhe me nominimin e minoritit (*Minoriten*) të Bosnjës si pasardhës të tij, këtu duhet thënë për këtë qeveria serbe nuk kishte qenë e informuar<sup>2</sup>. Ndërsa vetë Vujiçiq nuk kishte qenë i qartësuar lidhur me detyrën e tij dhe edhe nuni Taliani nuk kishte pranuar rekomandimet nga Roma e kështu që me rastin e një vizitës që i bëri Vujiçiq Vjenës nga këtu ai kishte udhëtuar për në Beograd - ai nuk kishte mundur të bënte më shumë se sa t'ia prezantonte ministrit të jashtëm austro-hungarez dhe ambasadorit serb. Tek disa javë më vonë, në qershor, më në fund Taliani kishte pranuar udhëzimin që ai të njoftoj zyrarisht qeverinë serbe për emërimin e Vujiçiqit nëpërmjet ambasades së Vjenës<sup>3</sup>. Me këtë çështje delicate Vatikani kishte bërë një sjellje të papërgjegjshme. Sekretariatit i shtetit nuk kishte reaguar as në nxitjen e nuncit e as në një shkresë të Josip Stadler-it në të cilën ai sekretarit të shtetit, Rampolla-s, ku i tërhoqet vërejtja për gjendjen e keqe të Vujiçiq-it. Në përgjigjen e tij lidhur me këtë çështje Rampolla nuk kishte marrë fare qëndrim, porse ai ishte shprehur optimizmin e tij se konkordati me Beogradin ishte i gatshëm për t'u nënshkruar, posa të sqarohet pyetja e martesave të përziera<sup>4</sup>. Përkundër këshillës së ambasadorit serb dhe nuncit të Vjenës që të pritët me udhëtimin e tij për në Beograd deri sa të nënshkruhet marrëveshja serbo-vatikanike dhe deri sa të vijë rekomandimet e saktë nga Roma, Vujiçiq udhëton në pranverën e 1898 për në Beograd dhe atje ai do pranohej nga kryeministri Gjorgjeviç mjaft ftohtë. Ai e kishte sugjeruar që ai ta lëshonte vendin përsëri, deri sa të sqarohet çështja. Mirëpo Vujiçiq jo vetëm që nuk e bëri këtë, por kërkoi edhe një audiencë të dytë tek kryeministri me që rast Beograd reagon menjë udhërbëhim.

Qeveria serbe ka pritur kërkesën për praninë të emërimit, ashtu siç është e zakonshme në diplomaci kështu e shpjegon këtë

Në paqen e Londrës, që nënshkruhet me 30 maj 1913, dekretohet tërheqja e Perandorisë Osmane gati nga të gjitha zotërimet evropiane; duhej të ngrihej një Shqipëri e pavarur. Përkatësia territoriale e Maqedonisë shpinte drejt një lufte tjetër mes ish aleatëve e cila përfundon me 10 gusht 1913 me Paqen e Bukureshtit. Greqis merr Selanikun, Serbisë i jepet Maqedonia Qendrore dhe Kosova. Me këtë jo vetëm se mbretëria serbe e dyfishon territorin e saj, ajo kishte rifituar vendëlidhjen e vjetër të serbëve e që lidhej me domethënie historike e ideologjike të betejës së Kosovës. Fakti se atje pjesa dërmuese e popullatës ishte shqiptare, injorohet fare nga Beogradi...

# Konkordati dhe ndikimi sllav kundër shqiptarëve

hap të rëndë ambasadori serb në Vjenë. Nunci kishte qenë i një mendimi tjetër se, njoftimi joformal i emërimit ka qenë tërësisht i mjaftueshëm. Edhe nëpërmjet një bisede direkte mes Talianis dhe Gjorgjeviç-it, kryeministrit serb e kishte vizituar atë në Nunciaturën Vjenë, nuk ishte arritur zgjidhja e konfliktit. Gjorgjeviç kishte kërkuar një njoftim zyrtar ku do duhej të jepeshin kompetencat e vikarit. Vetëm atëherë kur qeveria serbe të përgjigjet në atë shkresë, Vujiçiq do ketë mundësi të udhëtoj përsëri për në Serbi. Taliani përpigjet t'ia bëjë të qartë Gjorgjeviç-it se, vërtetë nuk përkon me praktikën diplomatike, mirëpo Selia e Shenjtë megjithatë do në të pranohet dëshirat serbe. Këtu kemi të bëjmë me persona mjaft të ndjeshëm (*di unaecessivitasuscutibilitat*), kështu i shkruan Taliani Rampolla-s, kështu që Vikarit Apostolik nuk do duhej t'i barten kompetencat të shumta<sup>5</sup>. Në Romë ndërkohë ishin bërë më të kujdesshëm dhe kërkoni nga Taliani një raport të detajuar lidhur me gjendjen e raporteve religjioze në Serbi e para se gjithash lidhur me ndikimin politik të ish mbretit Milan dhe të ndikimit të mbretit aktual Alexander<sup>6</sup>. Taliani në natën e krishtilindjeve të vitit 1898 dërgon në Romë raportin e kërkuar<sup>7</sup>. Aty ai ankohet për nivelin e ulët shkollor të popullatës serbe çka pasqyrohet edhe tek disa anëtar të qeverisë. Institucioni, "Propaganda" romane keqkuptohet plotësisht dhe se ajo shihet si majë shtize katolike kundër ortodoksisë. Në politikën e brendshme sundon kaosi, politikanë e përshkojnë kundërshtitë mes liberalëve dhe radikalëve. Partia liberale e Jovan Ristiç-it dominon, e cila edhe e përkrahë qeverinë Vladan Gjorgjeviç-it i cili vjen nga oborri (kabineti privat të mbretit) e kishte marrë vendin e Simiç-it që kishte marrë pushtetin për t'i stabilizuar raportet financiare të borxheve të mëdha që kishin shkaktuar ish mbreti Milan. Me



## Kundër ndikimit austro-hungarez

Takimi i parë i ambasadorit serb Jovanoviç tek nuni Scapinelli ishte me 14. Shkurt 1913 ku ia shpreh dëshirën e qeverisë serbe për fillimin e menjëherëshëm të bisedimeve për konkordatin. Beogradi si arsyejmë jep rritjen e popullatës katolike me aneksimin e Kosovës. Me çdo kusht, e kështu që me këtë qeveria serbe i bashkohet kushteve të paraqitura më herët, patjetër – duke aluduar në suverenitetin e Serbisë – të përjashtohet ndikimi i Austro-Hungarisë në bisedime.

këtë dukej se është liruuar rruga për rikthimin e Milan-it në Serbi e për të marrë pushtetin. Kushtetuta është hequr; Nikola Pašić-i, udhëheqësi i radikalëve që kishte frenuar drejtimin perëndimor të politikës serbe, është dënuar me nëntë muaj burg, liria e shtypit dhe ajo e tubimit janë kufizuar<sup>8</sup>. Liria e religjionit kishte qenë me kushtetutë e garantuar mirëpo katolikët e Serbisë vlerësoheshin si simpatizantë të partisë së afërt me Austrinë dhe sipas kësaj edhe janë trajtuar. Megjithatë qeveria pajtohet për një ipeshkvë katolik me rezidencë në Beograd me shprehjen se me këtë në çështjet e kultit katolik do të mund të emancipohet nga Monarkia e Habsburgëve. Pasi që Vujiçiq nuk guxonte më të shkoste në Beograd Selia e Shenjtë kishte rënë në një qorrrokak ku fillimisht nuk shihet dalje sepse bisedimet e drejtpërdrejta me Serbinë detyrohen të ngrihen për shkak të rrethanave të atjeshme kaotike politike<sup>9</sup>. Në

vitin 1901 kemi shenjat se qeveria serbe ishte e interesuar nëpërmjet nuncit të Vjenës për rifillimin e bisedimeve. Posa të zgjidhet çështja e martesave të përziera, qeveria serbe do jetë e gatshme të dërgoj një përfaqësues në Vatikan për bisedimet e mëtutjeshme, kështu thuhej nga Beogradi. Rampolla priste dhe tregojte i rezervuar<sup>10</sup>. Skepticizmi i tij ishte i saktë sepse edhe kësaj radhe nuk arrihet fillimi i bisedimeve. Me këtë në vitin 1903 nunci i Vjenës autorizohet që edhe njëherë të provoj një nxitje tek ambasadorit serb dhe të rripoformoj bisedimet me qëllim që përfundimisht të ngrihet e një administratë të rregullt kishtarë në Serbi<sup>11</sup>.

## Raportet serbo-vatikanike nën drejtimin e papës Piut X

Mbas aferës me Vujiçiq Selia e Shenjtë priste; një përpjekje tjetër për etablimin e një ipeshkvi në Beograd nuk do bëhet pa u marrë vesh paraprakisht me marrëveshje me Beogradit dhe Selisë së Shenjtë. Ndërsa Topolkoviç dhe më tutje mbetet në Beograd dhe Biljan në Kragujevc si misionarë e vetëm në Serbi. Czock do kthehet në Nish megjithë pakënaqësi nga ana e autoriteteve serbe, porse ai pak më vonë do vdes<sup>12</sup>. Në këtë kohë kishte disa kontakte paraprake mes nuncit të Vjenës dhe ambasadorit serb<sup>13</sup> por që edhe njëherë përfundojnë pa rezultate konkrete. Me vrasjen e mbretit Alexander dhe gruas së tij me 29 maj 1903 dhe me hipjen në fron në qershor të Petar I Karadošević-it dukej se një marrëveshje e mund-

shme mes Selisë së Shenjtë dhe Beogradit do shtyhej edhe më larg. Vrasja e mbretit ishte bërë nga ana e një konspiracioni të rrethëve nacionalistë të kryesuar nga Dragutin Dimitrijeviç (Apis) kurse bisedimet me Vatikanin refuzoheshin nga ky rreth. Nikola Pašićemërohet kryeministër dhe drejtoi reformat e brendshme politike. Si prioritet i politikës e jashtëme ishte bashkimi i gjitha rajoneve serbe nën drejtimin e Beogradit si dhe pavarësia e plotë e Serbisë nga Perandoria Osmane dhe nga Monarkia e Habsburgëve<sup>14</sup>. Megjithatë – apo mu për këtë arsye – nunci i Vjenës Belmonte merr përsëri kontakt me ambasadorin serb<sup>15</sup>. Njëherë më shumë pala serbe tregohet e hapur për dialog, mirëpo pa hyrë në bisedime konkrete<sup>16</sup>. Në vitet vijuese përqendrohen në mënyrë dramatike raportet austriake-serbe e që prej vitit 1906 një bojkot ekonomik do të kulmon me të ashtuquajturën 'Lufta e derrave' (Schweinekrieg)<sup>17</sup> kjo do t'i tensionoj edhe raportet serbe-vatikanike. Në një lëvizje të re për bisedime në vitin 1908 ambasadorit serb rekomandon Selinë e Shenjtë që të pres dhe i tërheq vëmendjen asaj për situatën politike kaotike në vendndihen e tij<sup>18</sup>.

Rreth pozicioneve fillestare nuk kishte ndryshim. Beogradi donte që me konkordatin të arrinte pavarësinë e plotë nga protektorati i Vjenës. Pas dorëheqjes së Strossmayer-it Serbia ishte drejt përsëritje nën Propaganda Fide – për dalim nga mendimi i shumë politikaneve serb e austriak – e jo nën administratën e ipeshkvit të Gjakovës<sup>19</sup>. Kushtet e paraqitura serbe për bisedimet për konkordatin për Selinë e Shenjtë ishin të paprurueshme. Beogradi jo vetëm që kërkonte diskrecion absolut por refuzonte edhe ngritjen e ndonjë ipeshkvi në tokën serbe. Përveç kësaj kisha katolike jo vetëm se duhej të tërhoqte nga një konkordatin formal por edhe nga aktivitetet misionare në Serbi<sup>20</sup>.

Në vitin 1912 ndërrohet situata gjeopolitike. Serbia bashkë me Malin e Zi, Greqinë dhe Bullgarinë themelojnë sëbashku Lidhjen Ballkanike me anë të së cilës mëtohej largimi i turqve nga Evropa. Pas kundërsesive ushtarake të aleatëve sukseder Perandorisë Osmane thirret Konferenca e Londrës ku kishte për qëllim gjetjen e një zgjidhjeje afatgjate. Në Paqen e Londrës, që nënshkruhet me 30 maj 1913, dekretohet tërheqja e Perandorisë Osmane gati nga të gjitha zotërimet



...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri përkonte me edicionin e 300-të, që ka bërë redaktori. Plot 300 javë na ndalim në kërkim të një imazhi sa më të veçantë të një periudhë kulturore potent dhe tepër të balancuar, duke kërkuar të veçantën e asaj që bën kulturën shqiptare në harkun një javor dhe speciale të ndryshme. Redaktori ishte i kënaqur me këtë numër edhe pse nuk i shpëttoi deri në fund disa konjukturave të nevojshme.

Shkrimi kryesor iu la në një prurje të mrekullueshme të Ardian Ndreçës, e cila i dedikohet Lazër Shtanos. "Shantaja si tanë poetët e mëdha, ka shquar gjana që të tjerët nuk i kanë pa. Të ndjekësh heshjen dhe gjysmaterrin e tij të mbrendshëm

lexuesi zbulon përfitimtë ma të kullueta që një shpirt mundet me çanësua. Ai ka shquar zanat e shtojzovallat, por - çka asht ma e randësishme - ka parandiej ngjalljen e një shpirti të ri ndër shqiptarë, ka pa sesi një pjesë e shqiptarëve, e lodhur prej zvetnimit të shekujve, dëshironte me çlirue ndërjegjejen e kombit edhe nepërmjet së bukurës", shkroi Ndreca dhe redaktori ndjeu kënaqësinë me trajtimin e leksikut të gënjesisë me të cilën shkruan autori. Ndërsa edhe në këtë numër vijon shkrimi super i gjatë i Konkordatit, Portës së Lantë dhe kuptohet interesave austriake në vend. Duhet thënë se këtë herë ishte radha e konkordatit serb, që kuptohet se nuk kishte peshën e një numri më parë që i dedikohet fatit të katolikëve shqiptarë dhe përpjekjeve për t'i

ruajtur ata. Redaktori solli një përkthim të Tomas Eliot, që duhet thënë se nuk e kënaqi shumë, kurse në momentet e fundit përgatitëm diçka edhe për të ndjerin Aton Ziti, bashkë me përkujtimin që bëhet në këtë rast. Një shkrim interesant ishte ai që lidhej me Vargas Llosën, që na kumtoi se "Elementi i fshetur a rëffimi i jashtëm nuk është për së koti apo arbitrar. Lypset që heshja e rëffimitarit të jetë domethënëse, që ajo të ushtrojë një ndikim të spikatur në pjesën e shprehur qartas të rëffentjes, me qëllim që kjo mungesë të ndihet kthjelltas e të përdozë kërshtërinë, prirjen me frymën pezull dhe përfytyrimin të lexuesi. Vetë redaktori shkroi diçka që lidhej

me Majlinda Kelmendi, piktoresh e njohur shqiptare që jeton në Kosovë. Majlinda përgatitë viteve ka mrekulluar me të gjithë strukturën koloristike të kompozicioneve, e mbi të gjitha guxim për të mos e përsëritur vetveten ndërkohë duke sjellë bashkëkohësi si në aspektin figurativ apo koloristik, shkroi ai, teksta pa punët e fundit të saj, realizuara në Kosovë. E theksojmë se numri ishte i mirë, porse pak i rëndë. Redaktori duhet të kishte mbasë një zgjidhje më të qetë dhe më përkujtimore për numrin e 300. Gjithsesi ishte numër i mirë. Grafika punoi mirë këtë herë dhe e imponuar në të gjithë këtë qerthull, që iu paraqit nga redaktori.

Evropiane; duhej të ngrihej një Shqipëri e pavarur. Përkatesia territoriale e Maqedonisë shpinte drejt një lufte tjetër mes ish aleatëve e cila përfundon me 10 gusht 1913 me Paqen e Bukureshtit. Greqisë merr Selanikun, Serbisë i jepet Maqedonia Qendrore dhe Kosova. Me këtë jo vetëm se mbretëria serbe e dyfishon territorin e saj, ajo kish të rifituar vendlindjen e vjetër të serbëve e që lidhej me domethënien historike e ideologjike të betejës së Kosovës. Fakti se atje pjesa dërmuese e popullatës ishte shqiptare, injorohet fare nga Beogradi. Shtypja e shqiptarëve me masat administrative brutale serbe në Kosovë shpinte jo vetëm drejt një kryengritjeje shqiptare, por edhe drejt një realizimi të politikës së brendshme. Kryeministri Pašić ia del me ndihmën ruse të ruaj postin, mirëpo mbreti Petar heq dorë në favor të djalit të tij Alexander-it.



Serbi mund të bëhet vetëm nëpërmjet ndryshimit të brendshme të ligjeve dhe nëpërmjet përmirësimit të të drejtave të pakicave dhe jo nëpërmjet përcaktimeve nga jashtë. Serbia, sipas Scapinelli-t, në asnjë aspekt nuk donë të dëgjojë për Austrinë, as si fuqi politike mbrojtëse e pakicave të saja e as si *Gendarme di Roma*<sup>25</sup>. Ashtu siç pritej në Konferencën e Lodrës Serbia refuzonte propozimin austriak për futjen në nivel ndërkombëtar të mbrojtjes së të drejtave të pakicave<sup>26</sup> (në Serbi, vër. e përkth.) për çka edhe kjo temë hiqet fare nga rendi i ditës.

Takimi i parë i ambasadorit serb Jovanović tek nuni Scapinelli ishte me 14. Shkurt 1913 ku ia shpreh dëshirën e qeverisë serbe për fillimin e menjëhershëm të bisedimeve për konkordat. Beogradi si arsyetim jep rritjen e popullatës katolike me aneksimin e Kosovës. Me çdo kusht, e kështu që me këtë qeveria serbe i bashkohet kushteve të paraqitura më herët, pa jetër - duke aluduar në suveranitetin e Serbisë- të përjashtohet ndikimi i Austro-Hungarisë në bisedime. Scapinelli potencon në përgjigjen e tij interesimin e Selisë së Shenjtë për bisedimet për konkordat, mirëpo ia cekë vështrësitë përkritazi me të drejtat e protektoratit austriak. Një qendër katolike në zemrën e sllavizmit (*in centro cattolico nel curie dello Slavismo del Sud*) do ta kufizonte përhapjen e ortodoksisë më mirë se sa protektorati i kultit austriak që nuk përkon më me të drejtën ndërkombëtare moderne, shprehjet optimist nuni Scapinelli<sup>25</sup>.

Pak ditë më vonë, 17 shkurt 1913, "Osservatore Romano" njofton emërimin e një komisioni serb për përgatitjen e bisedimeve për konkordat. Merry del Val ishte skeptik; me të njëjtat fjalë ashtu si edhe Vannutelli dy dekada më herët alarmon se, qëllimi i vetëm i Serbisë është emancipimi nga Austro-Hungaria pa qenë e gatshme të

Sllavizimi i shqiptarëve

Ashtu siç i sllavizoi Mali i Zi shqiptarët edhe për Serbinë çdo mjet do i jetë i mirësardhur që shqiptarët t'i bëjnë serbë, kështu ia tërheq vëmendjen Selisë së Shenjtë Ministria e Jashtme e Vjenës e që të mos e lejoj veten të përfillohet nga nacionalistët serbë.

bëj ndonjë lëshim përkritazi me epërsinë e kishës ortodokse. Përveç kësaj në rast të emërimit të ndonjë të huaji në postet kishtarë në Serbi priten rezistenca, e meqë nuk ka kandidat vendor, mund të ndodhë që këto poste të mos mund të plotësohet fare<sup>26</sup>. Megjithatë kështu prifti italian Dionigi Cardon, i cili kohë të gjatë ishte marrë me çështjen serbe, emërohet për parapërgatitjen e bazës së bisedimeve për Vatikanin e që kishte të bënte kryesisht me një rishikim të rezultateve të komisionit serb<sup>27</sup>. Më në fund Serbia ishte e gatshme ta mënjanoj pengesën më të madhe të gjertanishme e të pranjoj njohjen e kurorave të lidhura nga priftërinjtë katolikë.

Mirëpo prapë shpërthen një problem aktual për të cilin gjë më tani nuk është folur: liturgjia sllave. Përdërisa në propozimet e para të komisionit serb ende nuk bëhej fjalë për meshat në sllavish-



te, pala serbe ia deponoi Vatikanit këtë dëshirë në fillim të vitit 1914. Detyrimisht përkrahja e Vjenës duhej të fitohej në dy pika: në çështjen e liturgjisë si dhe përkritazi me të drejtat e protektoratit austriak. Në këtë aspekt Vjena insistonte për ruajtjen e të drejtave të nderit. Këtu hynin meshat festive me rastin e datëlindjes së Kajzerit dhe vendosja e portretit të tij nëpër famullit<sup>28</sup>. Ajo çka për Vjenën kishte në mend të parë vlerë simbolike nga Serbia ndjehej si kufizim i suveranitetit shtetërorë. Në bisedimet me ambasadorin e Vatikanit ishte vënë Eugenio Pacelli, në emër të Selisë së Shenjtë, në kërkim të një kompromisi në pikat e kontestueshme. Vështirësi nuk kishte vetëm për ipeshkvin titullar të Beogradit dhe Smederevës. Këtu bëhej fjalë për 22 titujt e nderit ipeshkvor që mund t'i ndante Kajzeri e që kishin të bënin me ish rajonet e kurorës Shtjefnit (Stefanskronë) që kishin rënë nën Perandorinë Osmane. Me ndarjen e këtyre titujve pretendohet kujtesa dioqezave të vjetra. Këta ipeshkvinj<sup>29</sup> me dy përjashtime-Tinia dhe Beogradi - nuk kishin qenë të shuguruar dhe se nuk kishin të drejta juridike, mirëpo kishin të drejtë të bartnin shenjtat e ipeshkvit. Megjë me titullin e Beogradit ishin të lidhura të drejtat faktike ipeshkvore - që nga viti 1853 këtë titull e mbante ipeshkvi i shuguruar i Zagrebit - Selia e Shenjtë detyrimisht duhej ta jepte pëllqimin e saj për emërimin e këtij ipeshkvi. Për mos t'ia hequr Monarkisë së Habsburgëve një ipeshkëv titullar Vatikanin propozon që ipeshkvin titullar të Beogradit ta lenë në Zagreb, mirëpo atë ta transferoj në një ipeshkëv greko-katolik e që do duhej të argumentohej me traditën greke të vjetër të postit ipeshkvor të Beogradit. Kështu që Selia e Shenjtë me këtë kishte mundësinë të ngritë një seli ipeshkvore latine në Beograd<sup>30</sup>. Edhe përbrenda kishës kishte zëra kritikë lidhur me synimin e lidhjes së një konkordati me Serbinë. Vizitatori apostolik i Bosnjës dhe Hercegovinës Pietro Bastien, tërheqë vërejtjen se, qeveria serbe konkordatin mund ta përdorte si instrument që popullatën katolike e sllavëve të jugut të Monarkisë së Habsburgëve t'i bindin për përfitimtë nëse ata do t'i takojnë shtetit të sllavëve të jugut të dominuar nga serbët jashtë Monarkisë së Habsburgëve<sup>30</sup>, një frikë e cila ndahej edhe brenda kurisë romane<sup>31</sup>.

Një vlerësim i autorizuar nga Kongregata e Riteve vjen në përfundim se në kohërat e mëherëshme në kishat katolike të rajonit të Serbisë të paktën disa pjesë të meshave janë celebruar në gjuhën e vjetër sllave dhe se me këtë janë të njëjtat rrethana ashtu si edhe për Malin e Zi ku është futur liturgjia sllave. Mirëpo vlerësuesi i Vatikanit rekomandon për një kufizim të liturgjisë sllave në kuadër të dekreteve të deritanismet të Kongregatës së Riteve me çka këto privilegje ishin të lidhura vetëm me disa kisha të caktuara. Me këtë përjashtohet një privilegj i përgjithshur i liturgjisë sllave për Serbinë kështu që i mundshëm ishte vetëm pranimi i sllavishës për famullit të caktuara lokale me ç'rast duhej të merrej parasysh që shqiptarëve të mos u imponohej sllavishja liturgjike kishtarë e me këtë të mënjanohej që kisha të bëhej bashkëfajtoreshë të një serbizimi të shqiptarëve. Vlerësimi ishte po ashtu për që rituali në gjuhën sllave, pra për ndarjen e sakramenteve, të lidhet me ato famullit, që e kishin poseduar të drejtën për përdorimin e sllavishës së vjetër e që ishte konformë normave standarde të Vatikanit. Kundër përdorimit të shkrimit cirilik për liturgjinë e vjetër sllave nuk kishte gjë kundër, mirëpo tërheq vëmendjen se në rastin Malit të Zi kjo ka qenë e pamundur për t'u realizuar<sup>32</sup>.

P

PUBLICISTIKA

NGA GJERGJ FRASHËRI

Cila do të jetë vlera aktuale e kësaj përpjekjeje për të shpjeguar arsyet politike të largimit nga atdheu të një shkrimtari shqiptar, kur ngjarje dhe këthesa politike ndodhën dhe po ndodhin ndërkohë në Shqipëri, të cilat janë pamëdyshje më të rëndësishme, pasi kanë të bëjnë me fatin ardhshëm të një populli të tërë. Fati i Ismail Kadarese, shkrimtarit shqiptar më të njohur në ambientin evropian, nuk mund të tërheqë vëmendjen më tepër nga ato që po ndodhin në Shqipëri. Por duke vënë re, se reputacioni që ai gëzon në botën e jashtme, i cili ka qenë vazhdimisht një dilemë për opinionin intelektual shqiptar përparimtar, po shfrytëzohet momentalisht në Shqipëri prej një kategorie intelektualësh, në programet e tyre politike që po propagandojnë për të ardhmen demokratike të këtij vendi, atëherë zbulimi i figurës së Kadarese në këtë kontekst, i kalon përmasat e interesimit rreth një individi. Sepse për opinionin shqiptar, figura e Kadarese është më komplekse prej asaj që njej bota e jashtme. Ajo qëndron midis veprave të shkrimtarit që kanë lindur dhe jetuar me sukses për tre dekada rresht në një terren komunist dhe midis asaj, që vetë ai për tërë këtë periudhë, ka gëzuar përkrahjen morale dhe ofiqe të larta zyrtare në udhëheqjen politike të diktaturës. Madje figura e tij do të jetë patjetër me interes të veçantë të gjurmohet për metamorfozën që pritet të ndodhë në orientimin e forcave të reja politike pluraliste që po pozicionohen ndërkohë për lëvizjet demokratike të ardhshme të vendit. Në këtë proces shëndërimi historik, zbulimi i rolit të veprës artistike dhe të pikëpamjeve ideologjike e politike të derisotme të Kadarese, do të marrë për mendimin tim një trajtesë afatgjatë për etapën e re, në rrugën plot intriga dhe me përvojë të medias së pushtetit në Shqipëri, për të "shembur" kultet e vjetra dhe në krijimin e "kulteve" të reja, vepra e të cilëve është e lidhur me veprën e kulteve të vjetra.

Braktisja e vendit në fundin e verës së kaluar dhe kërkesa për azil politik në Francë prej tij në fund të muajit tetor 1990, pikërisht kur në Shqipëri pas më se 40 vjetëve u krijua së fundi atmosfera e përshtatshme për lëvizjen demokratike, përbën ndoshta momentin me "motin më të kthjellët" për të parë figurën përherë të fshehur në mjegullën politike të Ismail Kadarese. Në opinionin e brendshëm shqiptar, gjesti i tij bëri fillimisht bujë. Diskutime jo zyrtare u hapën me shpejtësi, në se ikja nga Shqipëria dhe dorëzimi i tij politik në një vend tjetër, është për të mirën apo për të keqen e të ardhmes së vendit. Ata që thanë se bëri mirë, e panë si grusht

Këtë shkrim autori e ka nxjerrë nga ditari dhe shënimet analitike që ka mbajtur qysh në rininë e tij dhe vazhdon të mbajë edhe sot. Ai është shkruar më 31 janar 1991, kur ai punonte si shkencëtar i fuar (Gastwissenschaftler) në profesionin e tij si historian i ndërtimit dhe arkeolog në Universitetin e Mynihut. Veçanërisht ngjarjet e viteve 1989-1990 në Shqipëri dhe në Gjermaninë Lindore (Berlin, Brandenburg) – thotë Frashëri - i kam përjetuar tej mase intensivisht dhe me vëmendje të madhe në tërësinë e asaj që po ndodhte ditë pas dite...

## Përse I. Kadareja e braktisi Shqipërinë?

(meditime - 31 janar 1991)



Ismail Kadare

kundër prestigjit të pushtetit diktatorial, pasi vetë Kadareja ishte një nga përfaqësuesit e lartë politikë të tij. Të tjerët menduan se ai duhej të qëndronte në Shqipëri dhe të luftonte aty, po qe se vërtet, ai e ndjente veten demokrat dhe ëndëronte për t'i sjellë demokracinë popullit të vet. Por pati edhe nga ata që menduan se ai iku për interesat personale, për të jetuar i qetë dhe larg kokëçarjeve për fatin e vendit të tij, duke hequr dorë nga lufta për të ardhmen. Fakt është se jeta dhe qëndrimi i tij pas braktisjes së vendit, po u jep të drejtë në këto pak muaj këtyre të fundit.

Enigma e braktisjes së vendit prej shkrimtarit shqiptar, ndriçohet pikësepari nga vetë deklaratat e tij, e bërë me këtë rast në Paris me 25 Tetor 1990 dhe që gjendet e botuar me titullin "Ndarja me të keqen do të jetë kontribut dhe meritë e të gjithëve", në faqen e parë të numrit të parë (5 Janar 1991) të gazetës "Rilindja Demokratike", organ i porsa themeluar i Partisë Demokratike. Sipas deklaratës, autori pretendon se "vendimi për të lënë vendin është vazhdim logjik i asaj që kam bërë deri tani në veprën e tij", e cila shpjgohet se "deri më sot ai është përpjekur të ndihmojë për zbutjen e regjimit me ato mjete që kanë qenë të mundura në Shqipëri". Më poshtë, pasi njofton për përpjekje pa sukses që ka bërë

nëpërmjet takimeve dhe letërkëmbimeve në pranverën e vitit 1990 me Presidentin Ramiz Alia, për nevojën e demokratizimit urgjent dhe të plotë të vendit (për të cilat mjerisht publiku shqiptar ende nuk ka asnjë dijeni, pa e vënë aspak në dyshim vërtetësinë e pohimit të mësipërm), ai del me konkluzionin se: "duke mos pasur asnjë mundësi tjetër për të bërë të qartë pozicionin tim, meqenëse në Shqipëri nuk ekziston mundësia e opozitës legale, zgjedha rrugën (e ikjes - G.J.F.), që nuk do të dëshiroja kurrë t'ia rekomandoja askujt". Në pjesën tjetër të deklaratës autori tregon shqetësimin e tij për të ardhmen e Shqipërisë,

bën thirrje që ajo të mos pësojë fatin e një "katastrofe", duke shprehur së fundi edhe besimin që ai ka në demokratizimin e ardhshëm të vendit.

Ajo që të bie më shumë në sy prej kësaj deklarate të bërë më se tre muaj më parë, është heshtja e plotë e Kadarese rreth një angazhimi vetjak në luftën e tashme për të ardhmen demokratike të Shqipërisë, gjë të cilën ai nuk mungon t'iu bëjë thirrje dhe t'ia kërkojë të tjerëve. Nënteksti i deklaratës, që ruan më tepër vlerën e një amaneti për të tjerët në luftën e ardhshme, nënkupton tërheqjen e tij të plotë nga ndeshja e forcave demokratike me ato të regjimit në

fuqi. Kjo përputhet edhe në praktikë. Hapi i parë - largimi fizik nga vendi i ngjarjes. Hapi i dytë - tërheqja deri në fund nëpërmjet heshtjes. Mjaft interesant është pjesa "konçize" e deklaratës rreth shkakut të largimit të tij prej "mospërgjegjësisë së vetes në një opozitë ilegale". Kjo, megjithëse na bëhet e njohur për herë të parë si platformë e autorit dhe se në të vërtetë kjo dëshirë e tij ka qenë krejt e paditur për opinionin vendas, është lënë mjerisht e ç'veshkur nga argumentet bindëse. Kështu papritmas ne duhet të besojmë tani e tutje dhe ta shohim Kadarenë, në një farë mënyre (alibia e tij), si një "disident" të regjimit komunist.

Vështirë është të besohet se motivi i braktisjes së vendit prej shkrimtarit, të ketë qenë mungesa e një opozite legale, e cila do t'i jepte mundësi atij të bënte të qartë pozicionin e tij politik. Në kohën e largimit të tij, opozita legale të paktën në Tiranë, nëqoftëse nuk ka ekzistuar "de jure" ekzistonte "de facto". Lëvizjet politike masive që u shfaqën menjëherë pas ikjes së tij (ndoshta edhe më parë), të pasuara nga vendimet e qeverisë në fuqi mbi lejimin e pluralizimit politik në Shqipëri, dëshmojnë për lindjen e kësaj opozite. Ajo e tregoi veten të aftë të organizonte demonstrime masive dhe të formonte formacione politike. Pak javë pas largimit të Kadarese u krijua vetë dhe parë opozitare dhe më vonë u legalizuan parti të tjera. Megjithëse opozita sot në Shqipëri është "de juro", shkrimtari ynë nuk gjendet në skenën e re politike dhe ende nuk po e bën të qartë pozicionin e tij në të.

Në fakt, për tre dekada të aktivitetit të tij në Shqipëri, Kadareja nuk është njohur nga publiku shqiptar si një element me prirje opozitare dhe as ka qenë e tillë. Veprat fundamentale të tij i janë përkushtuar pa rezervë legendarizimit të kultit të Enver Hoxhës, kultit të PPSH-së, hyjnzimit të politikës së jashtme të Shqipërisë dhe kultit të izolimit të saj nga bota armike, kultit të mënyrës "shqiptare" të luftës së klasave, etj, etj, të cilat janë plotësisht në përputhje me ideologjinë dhe politikën e regjimit në fuqi, ndryshe ato nuk do të ishin botuar. Madje për propagandimin e tyre në botën e jashtme, atij nuk i mungoi ndihma e veçantë prej udhëheqjes së vendit, jo vetëm në përkthimin e veprave, por edhe në shpërndarjen e tyre nëpër libraritë e Perëndimit, e të tjera, përkrahje e cila nuk i është dhënë në atë masë asnjë shkrimtari tjetër shqiptar. Prej kësaj përkrahjeje dhe mirëkuptimit reciprok dhe pamëdyshje falë talentit të tij si shkrimtar, Kadareja u bë i njohur në ambientin evropian. Si shpërblim atij iu ruajt vazhdimisht vendi i nderit në elitën e lartë të udhëheqjes shqiptare, i shoqëruar edhe me ofiqe zyrtare të dorës së parë, të cilat i mbajti deri në ditën e vendimit për të braktisur vendin. Në këto kushte të jetës dhe të veprës së tij, Kadareja nuk mund të përbente një

### Çfarë po ndodh në Shqipëri?!

U bë tashmë disa muaj që dëgjoj nga mediet në Tiranë mbi "heroizmat" e I. Kadarese kundra diktaturës dhe diktatorit Enver Hoxha. Vendi po mbushet me pirgje-mullarë me "mollë të kalbura", që i nxjerrin herëpashere në treg për t'i shpallur monumente kulture të "disidencës së diktaturës" në Shqipëri, në letërsi dhe gjetkë. Natyrisht as që kanë qenë të tillë. Por mjerisht ka ende individë në këtë popull që pranojnë të shpallen të tillë, nën lehatimet e "analistëve, arkivistëve, opinionistëve, etj.", të konvertuar nga getot me kontingente besnike të pushtetit të vjetër dhe të ri. Ka ardhur dita, që sekretarë partie të PPSH-së po shiten si disidentë të PPSH-së, ndërsa fëmijët e sekretarëve janë pozicionuar si demokratë të mëdhenj, sepse baballarët e tyre kanë veshur me "cartonges" biografite e vjetra dhe i kanë lyer ato me bojë si vuajtës politikë nga PPSH-ja. Të gjithë këtë gjenjeshtrë historike po e mbështet media si teatër para nesh, që kemi jetuar njëherë dekadave të diktaturës, kemi punuar, vuajtur dhe gëzuar me familjet dhe fëmijët tanë – po luhet përpara syve tanë, që kemi qenë dëshmitarë të gjallë të kohës (!?).

element opozitë, pasi ka gëlltitur ndërkohë shumë luge nga supa e PPSHsë. Ky pozicion i tij i afirmuar ka qenë përherë i qartë në kohë, si për njerëzit e regjimit ashtu edhe për inteligjencën përparimtare që jetojnë sot në Shqipëri.

“Opozitë legale” që Kadareja kërkonte dhe nuk e gjeti në fund të muajit tetor të vitit të kaluar në Shqipëri, ka qenë shumica e popullsisë dhe inteligjencës, të paktën për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike. Në këtë opozitë ishin rreshtuar edhe disa shokë të ngushtë të tij, të cilët prej disa muajve më parë jepnin herë-pas-herë intervista “Zërit të Amerikës” dhe që pak javë më parë pas largimit të shkrimtarit, u shfaqën sado formalisht (apo si aktorë) në krye të Partisë së porsaformuar Demokratike. Për një adhures të demokracisë nuk ka qenë e pamundur gjëja e një pozicioni politik në fund të muajit tetor. Por pozicioni i tij ndoshta u bë i vështirë për tu përcaktuar për të ardhmen, pasi pikërisht drejt fundit të tetorit u duk qartë se në Shqipëri, përveç PPSH-së do të legalizoheshin edhe formacione të tjera politike. Me postin në të ashtuquajturin “Fronti Demokratik” që mbante, ai ishte në dijeni më herët se të tjerët për këto projekte. Midis këtyre alternativave të reja në horizont, kur pas vetes ke lënë një vepër të mirënjohur e të përkushtuar, për këdo është e vështirë t’i gjendet një pozicion i ri “i nderuar”. Kështu mund të besohet, kur në buzë të këtyre udhëkryqit, njeriu mund të bëhet padashur një pengesë e pandërgjegjshme e dëshirave të tij, rruga e lëvizjes përbën zgjedhjen më të mirë, si për vete ashtu edhe për t’i hapur rrugë të tjerëve.

Cili grupim politik mund t’i ndëshkonte Kadarenë – forcat e regjimit në fuqi? – Forcat e reja demokratike? – Apo një situatë e mundshme provizore e ngjashme me atë të Rumanisë? Askush nuk dyshon në Shqipëri, se ndonjë e keqe mund t’i vinte shkrimtarit nga regjimi në fuqi, apo nga levat e tij politike. Disa ditë pas largimit të tij qarkulloi dyshimi se njerëzit e Ministrisë së Punëve të Brendshme (të Sigurimit) kishin hartuar lista për “intelektualët e rrezikshëm të regjimit” dhe se në një moment të detyruar, këtyre intelektualëve shqiptarë do t’i pritshin kokat. Eksperiencia për këtë represalje në Shqipëri nuk mungon qysh prej kohës së Luftës së Dytë Botërore dhe njerëzit janë të prirur ta besojnë edhe pa qenë e dokumentuar. Në se për një moment kjo ka qenë e vërtetë, është e sigurt se emri i Kadaresë nuk ka qenë në këto lista – për shumë arsye, por kryesorja mbetet se ai nuk është atakuar asnjëherë me regjimin (aq më pak të ketë shpallur ndonjëherë duel disidentit kundër tij). Ndërsa vitet e fundit ai u ekspozua legalisht në presidiumet e Republikës, çka pohohet edhe në deklaratën e tij, gjë të cilën nuk e kishte arritur më parë. Madje, reputacioni i Kadaresë ka qenë deri ditën që e braktisi atdheun, një nevojë për të forcuar opinionin në popull se PPSH-ja ka njerëzit më të shquar rreth vetes. (Nga kjo pikëpamje largimi i Kadaresë duhet vlerësuar. Qëndrimi i tij i mëtejshëm në presidiumet e Republikës do të ishte një pengesë për një kategori intelektualësh, anëtarë të PPSHsë dhe të Lidhjes së Sh-



Ismail Kadare

krimtarëve dhe të Artistëve, që të hidheshin në radhët e Partisë Demokratike ku janë sot). Vetë qëndrimi që mbajti udhëheqja e PPSHsë me rastin e largimit të shkrimtarit – një vakum i papritur dhe me një kundërveprim pa “hakmarrjen” e zakonshme, tregon qartë se kundër tij nuk ka pasur asnjë qëndrim armiqësor, as të dyfishit, por përkundrazi një qëndrim tolerant. (Kadareja nuk është Lasgush Poradeci, që i këndon luleve, zogjve, dashurive dhe dashurikave tradicionale, peizazheve dhe liqeneve të Shqipërisë, etj., i cili mund të lihet edhe mënjani në situata revolucionare, por ai ishte borizan i PPSHsë).

Për atë ndoshta kishte nevojë “pluralizmi” në muajt që jetojmë, por “djali plangprishës” nuk iu përgjigj deri në fund. Në rast se qenia e emrit të tij në listat e Sigurimit është përdorur nga vetë shkrimtari si argument për të fituar azilin politik dhe për të lënë në Shqipëri një shkak bindës për largimin e “detyrueshëm” të tij nga atdheu, kjo është një çështje tjetër, që nuk i takon diskutimit tonë. Fakti është se nuk gjendet asnjë arsye që Kadareja të jetë projektuar për t’u ndëshkuar nga regjimi të cili ai ka shërbyer; dhe më tej akoma ai nuk do të jetë asnjëherë në këto lista, sido që të

ndodhë. Heshjtja e tij në vijim është për këtë një dëshmi. Ajo është ndërkohë një përgjigje e sjelljes së mirë ndaj epurve të vjetër: Detyrimet reciproke të krijuara në një kohë relativisht të gjatë bëhen shpesh pengesë për të kundërvepruar. Largimi i tij është tradhëti e parë dhe e fundit, përpara se stalinizimi i Tiranës të bëjë sikur po jep shpirt natyrisht.

Përgjigje të mëtejshme rreth pyetjeve që kemi shtruar mund të marrin nga vepra e shkrimtarit. Në se demokratizimi i plotë dhe i thellë i vendit ishte një amanet i shprehur në deklaratën politike të Kadaresë, ideve dhe filozofisë së kësaj demokracie qytetare bashkëkohore shqiptare nuk i gjenden gjurmë në tërë veprën e tij. Bashkë me idetë demokratike veprës i mungon kudo shtrati i tyre – humanizmi qytetar, i cili për fat të keq është mohuar (edhe nga shkrimtarë të tjerë të realizmit socialist) që ka një traditë historike edhe në Shqipëri. Në vend të tyre tashmë është bërë tipari dallues i veprës së shkrimtarit – acarimi përherë i tensionuar deri në ekstrem i grupeve të politizuara klasore brenda gjurit të një kombi, në shumë raste i përlyer me ndjenjen e hakmarrjes. Këtu nuk është fjala për një rast, kur ky acarim i ashpër ndjenjash vazhdon të mbijetojë në mënyrë romantike në zemrën e një populli kur dy të

huaj vinë në Shqipëri të mbledhin kokat e ushtarëve të vrarë në luftë, sepse edhe kënaqësia e castit që kërkon të imponohet nga një fakt i tillë, nuk është pa dëm më të mëdha, që burojnë nga përplekjet për t’i idealizuar këte acarim politik në skajë më të nxehta antinjerëzore (deri në vëllavrasje) dhe t’i ligjërojë në gjirin e shoqërisë bashkëkohore shqiptare, madje t’i paraqesë atë si të vetmen dhe më të mirën formë historike progresive të ekzistencës së saj. Politizimi i tejskajshëm i shoqërisë (deri edhe mbi ndjenjën kombëtare) ka qenë platforma mbi të cilën Enver Hoxha i lejonte shkrimtarët të bënin letërsi të realizmit socialist. Në veçanti ai sëbashku me Kadarenë u shquan për përplekjet serioze që t’i shihnin dhe ta gjykonin edhe historinë e herojve mesjetarë shqiptarë jo sipas botëkuptimit origjinal mesjetar shqiptar, por nga këndi i ideologjisë që u importua në Shqipëri merastin e Luftës së Dytë Botërore – i pari në fushën e “filozofisë” ndërsa tjetri në fushën e letërsisë. Le të bëjmë një analogji gjykimi për një rast faji të rëndë: Skënderbeu arriti t’i falë Hamza Kastriotin në mes të shekullit XV. Bëjmë pyetjen: A do t’i falte në praktikë një rast të tillë Enver Hoxha në kohën tonë? Dhe ç’pritej të shkruante I. Kadareja në veprën e posaçme që do të bënte me këtë rast? Mos ndoshta ai kishte ndërmend t’i falte në libër? Sigurisht që jo, në asnjë rast dhe madje pa dashur të dëgjon asnjë arsye. Por vetëm se do të interesojem më tepër për “kokën e prerë të Hamza”, se ku do të përfundonte pasi t’i bridhnin me javë të tëra për t’i tmerruar njerëzit ndër qytete me frikën e dhunës. Që të mos e falte Hamzain, kjo përbente “mjetin” e detyruar të kohës që vepra të botohej, por që të predikohet makabriteti si karakteristikë e jetës së shqiptarëve për hir të një mirazhi origjinal që duhet të kishte vepra që ajo të kishte sukses në ambientin letrar evropian, kjo nuk përbën “përplekje për të ndihmuar të shkrimtarit (dhe ky ka qenë fati i mirë), ato kanë trajtë të pabesueshme (jashtë vërtetësisë), duke anuar shpesh në trajtesa policiestke. Ato sigurisht nuk mund të serviren për lëndë demokratike. Në këtë kontekst zbardhet fjalia e parë e lënë në errësirë e shkrimtarit, sipas të cilit “vendimi për të lënë vendin është vazhdim logjik i asaj që ka mbrojtur deri tani në veprën e tij”, çka do të thotë, se vepra e tij u përkushtua me energji mbrojtjes së një sistemi dhe

se tashmë që ky sistem ndodhet në buzë të greminës, autori e humbi terrenin e tij dhe se hapi i parë më i madh i vazhimit logjik të kontributit që ka dhënë deri më sot, është largimi i tij fizik nga ai terren, ku forca të reja kundërshpirtare të predikimit të tij po rriten (përveçse mund të dalin edhe nga kontrolli i pushtetit prezent gati gjysmëshekullor).

Mundësia e marrjes së pushtetit prej forcave të vërteta demokratike në një të ardhme të afërt në Shqipëri, ka qëndruar në sfondin e vendimit të shkrimtarit për ta lënë vendin në një moment, kur për herë të parë pas aq dekadash filloi të flitej në sheshet e qyteteve të vendit me guhën e demokracisë. Intelektualët që e kanë pritur me adhurim këtë moment të madh historik të Shqipërisë nuk e kanë braktisur vendin, midis tyre janë të shumtë edhe ata që kanë të njëjtat pozicione me shkrimtarin, por sigurisht jo “famën” e tij. Megjithatë, për çështjen e Shqipërisë dhe të shqiptarëve në formatin kombëtar, ata do të hyjnë së shpejti në llogoret e luftës. Duke ngrënë bukë në kuzhinë parisiane, nuk e di se në cilin drejtim do të qëllojë shkrimtari nga këto llogore. E kisha fjalën, se veprën letrare të Kadaresë, si dhe të shumë shkrimtarëve shqiptarë, që ndërtauan të ashtuquajturën letërsi të “realizmit socialist”, e përkshon të e mbanë filozofia e praktika e “luftës së klasave”. Duhet të kujtojmë se kjo “luftë e klasave” e ngritur në sistem, u bë nëpërmjet dhunës një normë e re në historinë e popullit shqiptar të Pas Luftës, në kontrast të madh me marrëdhëniet shoqërore që kanë ekzistuar në të kaluarën e tij (burime të ndryshme studiuesish kanë vënë në dukje se populli shqiptar të paktën në shekujt e fundit, megjithëse ushqehet prej katër ideologjive të ndryshme fetare, nuk ka njohur luftë civile dhe kjo është parë si një prej rasteve të veçanta të historisë evropiane). Kult i metodës së “luftës së klasave”, që për një moment të vështirë të pushtetit në fuqi, kishte si qëllim final të merrte përmasat e “vrastjes së klasave” brenda shoqërisë shqiptare, ka lënë gjurmë të thella në Shqipëri. Veçanërisht indoktrinimi më i rëndë prej saj i takoi pikërisht brezit shoqëror të Ismail Kadaresë, sepse rinia e tyre u përputh me apogjeun e fuqisë së PPSH. Në këtë terren të ri të krijuar nga metoda e luftës së klasave, që mori trajtë më të ashpër pikërisht me të hyrë vitet 60’ shumë krijues të talentuar përfunduan në disidentë pasivë (disfatistë) dhe në fatkeqësi të mëdha, të tjerë u tërhoqën njëherë e përgjithmonë nga krijimtaria dhe fare pak mbetën si relike të traditës së vjetër letrare shqiptare, të cilët nuk e atakuan kurrë regjimin, por edhe letërsia e tyre për rrjedhojë u minimizua. Sigurisht që pjesa tjetër u rreshtua në shërbim të regjimit, duke pranuar t’i nënshtraheshin kërkesave të tij për një letërsi “militantë komuniste”, në themel të së cilës kërkohet “vrastja e klasave”. “Vënia e interesit të PPSH-së dhe të politikës së saj mbi gjithçka (deri edhe mbi atdheun)”, etj. Në këtë front u rreshtua plot energji e talent edhe Kadareja. Pikërisht për nga aspekti politik letërsia e tij arriti majtën e piramidës së fanatizmit.

(vijon)



Gjergj Frashëri

### Kur i kam shkruar?

Shënimet dhe analizat që jam munduar të shkruaj atëherë, kanë tërësisht karakter privat. Ato i kam hedhur mbromjeve dhe në fund javë, por edhe duke shrytëzuar kohën që përfitoja dy ditë në javë prej udhëtimeve të gjata për qëllime pune. Kur kam mbajtur këto shënime, nuk kam menduar asnjëherë se mund të bëja të njohura diçka prej tyre tek të tjerët, as edhe t’i botoja. Kam shkruar për të sqaruar veten, për t’i rielixuar ato në një kohë sa më të largët. Sepse kam pasur qysh herët ndjenjë, se shumë të vërteta në vendin tonë do të manipuloheshin në të ardhmen (në kohë), sepse ashtu paragatuheshin në kuzhinë. Kjo ndiesi më çoi në vetëdetyrimin, që të mbaja shënime in situ në kohë dhe hapësirë, për t’i rikujtuar vetes fillin e së vërtetës në origjin.

